



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën

Nr. 3634 Prot.

Tiranë, më 02.10 .2024

V E N D I M I S H K U R T U A R

Nr. 59, datë 02.10.2024

PËR MARRJE MASE DISIPLINORE

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën, në bazë të nenit 10/2 të Rregullores së Kuvendit, në datë 02.10.2024, u mbledh dhe shqyrtoi çështjen me:

Kërkues:

Arkend Balla, Ilirjan Pendavinji, Baftjar Zeqaj, Ilir Topi, Ilir Ndraxhi, Enslemvera Zake, Pranvera Resulaj, Denis Deliu, Ermonela Valikaj, Laert Duraj, Niko Peleshi, deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për situatën e krijuar në seancën plenare të datës 30.09.2024.

Objekti:

- *Kërkesë datë 01.10.2024:*
- Marrje masë disiplinore “Përrjashtimin nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare” ndaj deputetëve Gazment Bardhi, Flamur Noka, Bledion Nallbati, Edi Paloka, Saimir Korreshi, Lefter Gështenja, Luan Baçi, Dashnor Sula, Agron Gjekmarkaj, Dhurata Çupi, Xhelal Mziu, Ina Zhupa, Zheni Gjergji, Helidon Bushati, Lindita Metaliaj, Ramadan Lika, Asllan Dogjani, Qani Xhafa, Flamur Hoxha, Isuf Çela, Kastriot Piroli, Lodovik Hasani, Kasem Mahmutaj, Edmond Spaho, për situatën e krijuar në seancën plenare të datës 30.9.2024.

Sekretariati mori në shqyrtim kërkesën e deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për marrjen e masës disiplinore ndaj deputetëve Gazment Bardhi, Flamur Noka, Bledion Nallbati, Edi Paloka, Saimir Korreshi, Lefter Gështenja, Luan Baçi, Dashnor Sula, Agron Gjekmarkaj, Dhurata Çupi, Xhelal Mziu, Ina Zhupa, Zheni Gjergji, Helidon Bushati, Lindita

Metaliaj, Ramadan Lika, Asllan Dogjani, Qani Xhafa, Flamur Hoxha, Isuf Çela, Kastriot Piroli, Lodovik Hasani, Kasem Mahmutaj, Edmond Spaho.

Pas shqyrtimit të kërkesës, Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën në zbatim të neneve 10/2, pika 2, 63 pika 1 gërma “d”, 65/1 pika 1 gërma “a”, 65/1 pika 6 gërma “b”, pika 7 gërma “a” dhe 65/2, të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 8 të Kodit të Sjelljes së Deputetit:

V E N D O S I :

1. “Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për deputetët Gazment Bardhi, Flamur Noka, Bledion Nallbati me 60 ditë”, duke filluar nga data 03.10.2024 deri më datë 1.12.2024.
2. “Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 40 ditë” për deputetët Saimir Korreshi, Lefter Gështenja, Luan Baçi, Dashnor Sula, Agron Gjemarkaj, Dhurata Çupi, Xhelal Mziu, Ina Zhupa, Zheni Gjergji, Helidon Bushati, Lindita Metaliaj, Ramadan Lika, Asllan Dogjani, Qani Xhafa, Flamur Hoxha, Isuf Çela, Kastriot Piroli, Lodovik Hasani, Kasem Mahmutaj, Edmond Spaho, duke filluar nga data 3.10.2024 deri më datë 11.11.2024.
3. “Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 10 ditë” për deputetin Edi Paloka, duke filluar nga data 3.10.2024 deri më datë 12.10.2024.
4. Ngarkohet “Shërbimi i Sigurisë në Kuvend” dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim mund të ankimohet nga deputeti brenda 2 (dy) ditëve pranë Byrosë së Kuvendit.
6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 3.10.2024.

S E K R E T A R I

Klotilda BUSHKA

ANËTARËT

Jurgis CYRBJA



Klevis XHOXHI